

Nr prot. 137/9

Datë 22.01.2020

**MARRËVESHJE “PËR NDRYSHIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET INSTAT DHE QKB”**

Ndërmjet

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
në vijim referuar si “INSTAT”

dhe

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
në vijim referuar si “QKB”

Mbështetur në Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” si dhe duke patur parasysh vullnetin për bashkëpunimin e ndërsjellë, Palët bien dakord të kryejnë shtesat dhe ndryshimet në Memorandumin e Mirëkuptimit si vijon:

1. Në të gjithë përbajtjen e memorandumit “Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar” zëvendësohet me “Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”.

2. Preamble e Memorandumit zëvendësohet me këtë përbajtje:

- Instituti i Statistikave (në vijim referuar “INSTAT”) është institucioni përgjegjës për të siguruar që statistikat janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas parimeve të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, (në vijim referuar “Ligji i statistikave”);
- Neni 13, pika 2 (ë) e ligjit të statistikave parashikon që INSTAT mund të hartoje, negocijoje e të nënshkruejë memorandume mirëkuptimi me të gjitha agjencitë statistikore dhe me mbajtësit e të dhënave administrative, duke përfshirë organizimet e punës dhe detyrimet e palëve;
- Neni 13, pika 1 (ç) e ligjit të statistikave INSTAT duhet të marrë pjesë në proceset e krijimit dhe zhvillimit të sistemeve të të dhënave administrative, për tu përdorur për qëllime statistikore;
- Neni 25, pika 8 e ligjit të statistikave detyron të gjitha institucionet publike të njoftojnë INSTAT-in për çdo projektakt të propozuar për miratim në Këshillin e Ministrave apo Kuvend, i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në veprimtarinë statistikore që ushtrohet në Republikën e Shqipërisë;
- Neni 33, pikat 1 e ligjit të statistikave parashikon që të gjitha institucionet qendrore dhe vendore i jepin INSTAT-it të drejtën e hyrjes pa pagesë në regjistrat, skedarët e të dhënave dhe të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura, sipas përgjegjësive

përkatëse, në masën që është e nevojshme për nxjerrjen e statistikave, duke shmangur ngarkesat në përgjigje për njësitë statistikore;

- Neni 33, pikat 2 e ligjit të statistikave detyron institucionet publike të informojnë INSTAT-in për krijimin e çdo dokumentacioni të ri me të dhëna administrative apo për ndryshimin e atyre ekzistuese;
- Neni 31 i ligjit të statistikave detyron INSTAT-in të trajtojë si konfidenciale çdo të dhënë të mbledhur, përpunuar dhe ruajtur për nxjerrjen e statistikave zyrtare;
- Neni 40, pika 1 e ligjit të statistikave parashikon që ky ligj prevalon ndaj çdo dispozite të parashikuar në ligje të tjera, në bazë të cilave ushtrojnë veprimtarinë institucionet publike, gjë që bëhet pengesë për dhënien dhe transmetimin e të dhënavë administrative për qëllime statistikore ose për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënavë të mbledhura vetëm për qëllime statistikore;
- Qendra Kombëtare e Biznesit ngrihet dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;

Si dhe duke patur parasysh që Sistemi Kombëtar Statistikor bazohet në një bashkëpunim të ngushtë mes INSTAT-it nga njëra anë dhe agjencive të tjera statistikore dhe mbajtësve të të dhënavë administrative nga ana tjetër,

Instituti i Statistikave dhe Qendra Kombëtare e Biznesit bien dakort të nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit si vijon:”

3. Në Seksionin 4 “Udhëzimet për standartet profesionale”, paragrafi (1) ndryshohet si më poshtë:

“(1) INSTAT detyrohet të vendosë në statistikat zyrtare të gjitha përkufizimet statistikore, klasifikimet dhe nomenklaturat, në përputhje me konceptet dhe klasifikimet ndërkombëtare, aty ku është e mundur (Neni 14, pika 2 (e) e ligjit të statistikave).”

4. Në Seksionin 5 “E drejta e hyrjes dhe shkëmbimi i të dhënavë”, paragrafi (5) fjalë “Neni 15” zëvendësohet me fjalën “Nenin 31”.

5. Në Seksionin 6 “Sigurimi i zbatimit të përshtatshëm të Programit” bëhen këto ndryshime:

- a. Në paragrafin (2), fjalët “Këshillit të Statistikave” zëvendësohen me fjalën “Kuvendit”
- b. Paragrafi (3) hiqet.


6. Ndryshimet e parashikuara në këtë Marrëveshje për Memorandumin e Mirëkuptimit hyjnë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve.

**PËR
QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT**

PRANVERA FAGU (BEHUSHI)

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Data e nënshtakimit



**PËR
INSTITUTIN E STATISTIKAVE**

ELSA DHULI

**ZËVENDËSKRYETAR I BORDIT
DREJTUES**

Data e nënshtakimit

22/01/2010

